



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 106/2013
Prishtinë, më 21.05.2013, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala S–II

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti – kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha – Shala, Fikrim Damka dhe Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Mungoi: Visar Ymeri.

Pjesëmarrës i ftuar: **Ahmet Krasniqi**, ushtrues detyre i kryetarit të bordit i Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës –AKK-së.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi - ZPRK; Dita Dobranja – INDEP; Fehmi Pireva - Kuvendi i Kosovës dhe Qëndresa Mrasori- praktikante.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit dhe Teuta Sahatqija, zëvendëskryetare e parë e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.05.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës –AKK, për vitin 2012;
4. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime i Projektligjit nr. 04/L-181 për produktet e ndërtimit;
5. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime i Projektligjit nr. 04/L-187 për treguesit gjeografikë;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.05.2013

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 15.05.2013 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës për vitin 2012

Kryetari – Theksoi se ashtu siç është paraparë, në këtë pikë të rendit të ditës, do të shqyrtohet Raporti vjetor i Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës, për vitin 2012. Ne kemi ftuar përfaqësuesin e - AKK-së, z. Ahmet Krasniqi, i cili do të paraqesë një prezantim të shkurtër për këtë Raport dhe pastaj të hapet debat. Për shkak të një agjende të papritur, kërkoi nga deputetët të lejohet për t’u liruar nga mbledhja dhe kryesimin e mbledhjes ia dha zëvendëskryetares së parë, znj. Teuta Sahatqija.

Ahmet Krasniqi, ushtrues detyre i kryetarit të bordit të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës (AKK) - I njoftoi deputetët se Raporti paraqet një pasqyrë të aktiviteteve të zhvilluara dhe arritjeve kryesore të AKK-së, gjatë vitit 2012. Ai tha se raporti është hartuar edhe duke u bazuar në zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Foli për çështjen e moszgjidhjes së problemit të zyrave që e ka ende AKK-ja. Lidhur me këtë çështje tha se, edhe pse na janë ndarë 50 mijë euro për qira, por me këtë shumë në bazë të llogarive që kemi bërë, nuk kemi mundur të bëjmë zgjedhje. Ai pastaj paraqiti në mënyrë kronologjike të gjitha aktivitetet që janë realizuar dhe sfidat nëpër të cilat po kalon AKK-ja. Ai theksoi se Raporti është ndarë në disa pjesë dhe përmban informacione për ngjarjet më të rëndësishme për konkurrencën në treg, si dhe të dhëna për aktivitetet në sektorin e konkurrencës në Republikën e Kosovës. Tha se AKK-ja si subjekt juridik me autoritet publik, kryen detyrat e mbrojtjes së konkurrencës, konstatim i marrëveshjeve të ndalura ndërmjet ndërmarrjeve, abuzimit me pozitën dominuese dhe përqendrimet e ndërmarrjeve, si dhe nga viti 2012, me hyrjen në fuqi të Ligjit për ndihmat shtetërore, do t’i kryejë edhe detyrat e vlerësimit, lejitimit dhe monitorimin e ndihmave të mundshme shtetërore, në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe Ligjit për ndihmat shtetërore. Theksoj se Raporti, në mënyrë sistematike, paraqet aktivitetet kryesore që ndërlidhen me konkurrencën dhe mbrojtjen e saj, punët kryesore të cilat Autoriteti i Konkurrencës i ka ndërmarrë në vitin 2012 dhe në mënyrë qartë paraqet dhe shpjegon natyrën e punës së konkurrencës, si një fenomen ekonomik delikat. Gjatë vitit 2012, janë hartuar disa udhëzime administrative nga AKK-ja, duke u bazuar në zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Theksoi se AKK-ja, në bashkëpunimin ndërkombëtar, paraqitet si homologe dhe palë e barabartë ka marrë pjesë aktive në të gjitha aktivitetet organizuar ndërkombëtarë në rrjetin konkurrencës si në trajnime, seminare dhe konferenca. Po ashtu, njoftoi se në bashkëpunim me Ministrinë për Tregti dhe Industri, janë duke e amendamentuar Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, në bazë të rekomandimeve të Kuvendit apo të këtij komisioni parlamentar.

Kryesuesja – Në kuadër të Raportit të AKK-së për vitin 2012, po ashtu edhe nga shoqëria civile, INDEP, që po e ndihmon punën e Komisionit, kemi një analizë që ka të bëjë me këtë raport, që pasqyron punën AKK-së. Pyeti lidhur me çështjen e pazgjidhur të zyrave: Çka ju duhet më saktë që ne si Komision funksional t’ju ndihmojmë? Kërkoj të dhëna të sakta për staf dhe pse nuk ju përgjigjen 50 mijë euro për gjetjen e një lokacioni? Pse mungon edhe një pasqyre dhe analizë

krahasuese me raportin e vitit 2011 dhe 2012? Zyra e Auditorit të përgjithshëm ka shprehur disa shqetësime lidhur me mënyrën shpenzimeve të buxhetit, cilat janë masat të cilat i ka marrë AKK-ja për t'ju përmbajtur Ligjit për menaxhimin e financave publike? Për privatizimin distribucionit të KEK-ut nga ana e konserciumit "LIMAK dhe ÇALIK", a ka shkelje të konkurrencës? Po ashtu për Projektligjin për tregun e naftës dhe produkteve të naftës, kërkoi një opinion profesional nga AKK për nevojat të komisionit.

Hashim Deshishku – Parashtroi disa pyetje: A ka mundur që AKK-ja që dy vite të funksionojë pa bord të kompletuar, nëse po, si po funksionon? Për rritjen e çmimit të biletave të udhëtarëve për rajonin e Pejës, a ka pasur marrëveshje ndërmjet kompanive të autobusëve që të rritet çmimi i biletave të udhëtarëve? Për prodhuesit e bukës nga shoqata e furrtareve të bukës dhe miellit, a kanë pasur marrëveshje për rritjen e çmimit të bukës? Për kompanitë e sigurimeve, lidhur me ndarjen e tregut, këtu thuhet në raport se në mungesë të ekspertëve të TI-së, nuk është bërë ndarje e tregut, pse nuk po angazhon ekspertë të jashtëm? Për "Kozmodet", a është e regjistruar si shoqatë apo si kompani? Te raporti financiar te pasqyrat e pagave dhe mëditjeve janë paraqitur disa shuma dhe shifra fikse, si p.sh. 85 mijë euro, si ka reaguar auditori i jashtëm, a është bërë llogaritja e saktë?

Myzejene Selmani - Lidhur me raportin tha se në vitin e kaluar raporti ka qenë më i detajuar, por në këtë raport për vitin 2012, mungojnë të dhënat e hollësishme se si janë zhvilluar procedurat e marrjes së vendimeve. Kërkoi të dijë se si po funksionon Bord, sepse ai nuk është i kompletuar. Kërkoi që t'i sjellin ndryshimet nga raporti i vitit 2011 dhe 2012. Tha se neve na interesojnë politikat e konkurrencës në mes të shteteve, si dhe ligjet që kanë të bëjnë me konkurrencën, ndërsa ju duhet të jepni opinionin e juaj, si Autoritet i konkurrencës, për të parandaluar dhe ndaluar monopolin në treg. Po ashtu, propozoi që gjatë hartimit të projektligjeve, pra kur hartohen nga ana e Qeverisë, AKK-ja duhet të jetë pjesëmarrës në grupet punuese, për t'i paraqitur vërejtjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konkurrencës. Gjithashtu, kërkoi që të shtohet stafi profesional, duke marrë parasysh se çfarë institucioni i rëndësishëm është AKK-ja, dhe në fund, kërkoi raport shtesë me shkrim.

Sala Berisha – Shala – Pyeti: A ka pasur ndonjë rast, që për shkak të moskompletimit të Bordit, AKK-ja të mos marrë vendime? Tha se raportit të punës së AKK-së, prej vitit në vit, po i mungon analiza, kur dihet se që sa vite po funksionon ky Autoritet. Theksoi se u ceken disa gjera që nuk janë në Raportin e punës së vitit 2012 dhe çështjet që mbeten të hapura dhe sfidat që nuk varen nga AKK-ja. Gjithashtu, kërkoi që të sjellë në raportin shtesë të gjitha çështjet që u ngritën. Dhe në fund, kërkoi që të përfshihen në grupet punuese për hartimin e projektligjeve, si dhe të jepni kontributin si Autoritet në përpilimin e legjislacionit.

Shaip Muja - Tha se për problemin e çimentos dhe naftës që janë ngritur, se po krijon monopole dhe pozitë dominuese në tregun e konkurrencës, nuk është dëgjuar dhe pasqyruar drejt nga aspekti ligjor. Prandaj, kërkoi nga AKK-ja që të sjellin udhëzimet në raportin shtesë se ku po shkelet Ligji për mbrojtjen e konkurrencës. Po ashtu, kërkoi që përfshihen në grupet punuese për hartimin e projektligjeve dhe të japin kontributin e tyre. Propozoi që të kompletohet raporti, me të gjitha të dhënat që u ngritën, pastaj të procedohet në seancë plenare.

Ahmet Krasniqi, ushtrues i detyrës së kryetarit të bordit të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës (AKK) - Iu përgjigj pyetjeve që ngritën nga anëtarët e Komisionit. Për çështjen e hapësirave të zyrave, tha se iu kemi drejtuar ministrit të Administratës Publike, z.Mahir Jagxhillar, me pesë kërkesa radhazi, që t'ju gjendet ndonjë objekt që të vendosen dhe të bëjnë zgjedhje, por deri më tani nuk është kthyer asnjë përgjigje zyrtare. Sa i përket funksionimit të AKK-së pa dy anëtarë të bordit, tha se po na paraqet vështirësi, por kemi gjetur mirëkuptim me tre anëtarët e tjerë të bordit, që vendimet t'i marrim me pajtim të plotë apo unanimisht, sepse ligji thotë se për të marrë një vendim, duhet të kemi së paku tri vota për apo vota afirmative.

Krahasimi i raportit të vitit 2011 dhe 2012, nuk është bërë, por këtë do ta bëjmë në raportin shtesë që do t'ua sjellim. Për kompanitë që janë partnere që kanë bërë privatizimin e distribucionit të rrjetit të energjisë elektrike, tha se vetëm është nderuar titullari dhe nuk paraqet shkelje të ligjit. Për çmimin e biletave në rajonin e Pejës, tha se e kanë marrë një kërkesë nga organizata studentore "Paqja e studentore", që të shikohet se a ka marrëveshje në mes kompanive të autobusëve për ngritjen e çmimit të biletave të udhëtarëve. Në vijim, ai tha se AKK-ja e ka ftuar Shoqatën e agjencive të autobusëve dhe përfaqësuesit e studentëve "Paqja studentore" në një takim të përbashkët dhe janë pajtuar të dy palët që të lirohet çmimi i biletës për studentët e këtij rajoni në raste të caktuara dhe e kanë shfuqizuar marrëveshjen. Për çështjen e ndarjes së tregut të kompanive të sigurimeve, tha se kjo ende nuk është bërë, për shkak të mungesës së stafit të ekspertëve të IT-së. Për "Kozmodet" tha se është e regjistruar si shoqatë apo kompani, ndërsa për këtë nuk mund t'ju japë përgjigje të saktë, sepse tani nuk e kam regjistruar, por për këtë do t'ju njoftojmë në raportin shtesë që do t'ua sjell në Komision. Për raportin me pasqyra financiare, tha se për këtë çështje do të raportojnë në Komisionin funksional për Buxhet dhe Financa. Për kompaninë "Sharrcem" tha që janë në fazën e hetimit dhe në pritje të marrjes së vendimit se a ka pozitë dominuese në treg, tha se vendimi pritet të merret duke u bazuar në Ligjin për mbrojtjen konkurrencës. Për Projektligjin për tregun e naftës dhe produkteve të naftës, tha se do të analizojnë dhe do të japin opinionin e tyre. Në fund, tha se do t'ju ofrojmë të gjitha të dhënat që u ngritën, për të gjitha çështjet që u ceken, sesi ka ecur në detaje gjatë vitit 2012 dhe shtoi se jemi duke punuar në kushte të vështira si Autoritet, sepse nuk kemi përkrahje, duke marrë për bazë mungesën e buxhetit, stafit, bordit dhe zyrave etj.

Kryesuesja - Në fund të diskutimeve që bënë dhe përgjigjeve që morën deputetët lidhur me interesimin e tyre, kërkoi që për të gjitha çështjet që u kërkuan dhe morën përgjigje të detajuar, pra që të sillet edhe një raport shtesë. Ajo, po ashtu, në emër të Komisionit e inkurajoi kryesuesin e Bordit të AKK-së, z. Krasniqi që të vazhdojnë me punën e tyre, për t'ju përmbajtur obligimeve ligjore. Në fund, ajo tha se për t'i tejkaluar sfidat që mund të paraqiten gjatë zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, do t'ju ofrojmë mbështetjen e vazhdueshme të Komisionit.

Pas debatit të gjerë, me gjashtë (6) vota për dhe dy (2) abstenime, Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i punës së Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës për vitin 2012.

Kuvendit ia paraqiti këtë

Rekomandim

- 1. Të miratohet Raporti vjetor i punës së Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës për vitin 2012.*
- 2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet kryetari i Komisionit, Zenun Pajaziti.*

4. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime i Projektligjit nr. 04/L-181 për produktet e ndërtimit

Kryesuesja -Tha se pas shqyrtimit edhe nga ana e komisioneve të përhershme të Raporti me amendamente për Projektligjin nr. 04/L-181 për produktet e ndërtimit, nuk ka dhënë ndonjë vërejtje, dhe sipas Rregullores së Kuvendit, duhet të procedohet për seancë plenare.

Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet Raporti me rekomandime i Projektligjit nr. 04/L-181 për produktet e ndërtimit.
2. Raporti t'i procedohet Kuvendit, sipas procedurës për lexim të dytë.

5. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime i Projektligjit nr. 04/L-187 për treguesit gjeografikë

Kryesuesja –Theksoi se edhe për këtë Projektligji, pas shqyrtimit edhe nga ana e komisioneve të përhershme të Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 04/L-187 për treguesit gjeografikë, nuk ka dhënë ndonjë vërejtje, dhe sipas Rregullores së Kuvendit, duhet të procedohet për seancë plenare.

Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet Raporti me rekomandime i Projektligjit nr. 04/L-187 për treguesit gjeografikë.
2. Raporti t'i procedohet Kuvendit, sipas procedurës për lexim të dytë.

6. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Kryesuesja – I njoftoi deputetët e Komisionit lidhur me përfundimin e seancës plenare për Projektligjin për tregun e naftës dhe produkteve të naftës se ngarkohemi si Komision funksional që të shqyrtojmë propozimin shtesë të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, dhe pas shqyrtimit, Kuvendit t'ia paraqesim raportin me rekomandime. Po ashtu, në bazë të këtij përfundimi, edhe Komisioni për Legjislacionin ngarkohet që ta shqyrtojë kushtetutshmërinë e projektligjit në fjalë.

Lutfi Zharku –Në parim, kërkesa e MTI-së që të shqyrtojmë propozime shtesë, është çështje e deputetëve dhe e Komisionit, që në grupin punues mund ta shqyrtojnë dhe kjo shkresë është e pa pavarëshme, sepse Projektligji për tregun e naftës dhe produkteve të naftës, tani është në procedurë të rregullt në Kuvend.

Shaip Muja- Theksoi se sa i përket çështjes së kushtetutshmërisë që e ka ngritur opozita, duhet të thuhet saktë dhe të ceket se në cilin nen bie ndesh Projektligji për tregun e naftës dhe produkteve të naftës. Pastaj, që mos të kemi dilema dhe lajthitje gjatë shqyrtimit në Komision.

Kryesuesja - Propozoi që kjo shkresë me këtë përfundim, të shqyrtohet në mbledhjen e radhës si pikë rendit të ditës.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me propozimin e kryesues.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit